

SARANDA

Qyteti i Sarandës, ose “porta detare jugore e Shqipërisë”, ndodhet e pozicionuar si në një ballkon natyror, përballë ishullit të Korfuzit. Linjat e trageteve janë të përditshme dhe lidhin këtë ishull të Greqisë me Sarandën. Emri i sotëm i Sarandës rrjedh nga prezenca e një manastiri të hershëm kristian i “Dyzet Shenjtorëve”. Rrënojat e këtij objekti ndodhen në Qafën e Gjashtës, në hyrje të qytetit.

Në vazhdim të udhëtimit drejt jugut, bregdeti bëhet i larmishëm, dhe ofron katër ishuj të vegjël, (zona e Ksamilit), të mbuluar me vegjetacion mesdhetar, faunë dhe florë të mrekullueshme detare. Në anën tjetër ndodhet liqeni i Butrintit me ujë të kripur, pasi është një lagunë bregdetare me origjinë tektonike. Ajo lidhet me detin nëpërmjet kanalit të Vivarit me gjatësi 3,6 km. Në këtë lagunë folezon një numër i konsiderueshëm shpendësh detarë.



SARANDE - BUTRINT 18 km

Saranda shtrihet në fund të bregdetit të Jonit dhe ofron një shëtitore të këndshme me palma, si dhe plazhe të vegjël zallorë. Në qendër të saj gjenden rrënojat e qytetit antik të Onhezmit, i shkatërruar në shek. e V nga dyndjet e barbarëve.

Së fundmi, (në vitin 2002), është zbuluar madje dhe një sinagogë. Vetëm 2 km. në jug të Sarandës, në një kodër dominante, ndodhet kalaja e Lëkursit. Fortifikimi u ndërtua nga Sulltan Sulejmani gjatë fushatës për pushtimin e Korfuzit. Tashmë në kala, ndodhet një restorant, i cili krahas kuzhinës të pasur, ofron edhe një pamje të mrekullueshme të blusë së thellë joniane.



BUTRINTI

Në jug të liqenit, rreth 18 km nga Saranda, shtrihet qyteti antik i Butrintit, pika më e rëndësishme arkeologjike e Shqipërisë dhe që ndodhet në listën e UNESCO-s.

Butrinti përmendet që prej shek. të VII para Krishtit, si qyteti më i rëndësishëm i Epirit. Sipas Dionisit të Halikarnasit, krijimi i Butrintit lidhet me kalimin në atë zonë të princit trojan Enea gjatë rrugëtimit të tij për në tempullin e Dodonës. Për nder të Orakullit të Dodonës, ai sakrifikoi një dem, (në greqisht BUTHROS), në vëndin ku u ngrit qyteti i Butrintit. Vizita e Eneas në Butrint përmendet edhe nga poeti romak Virgjili, tek “Eneida”.



Objektet e vizitueshme në Butrint janë të shumta, por ndër më të spikaturat mund të përmendim tempullin e Asklepit, (perëndia e shëndetit, shek. i II para Krishtit), teatrin me 1.500 vënde, i shek. të III para Krishtit, (ku në çdo shtator zhvillohet “Festivali Ndërkombëtar i Teatrove), nymfeun, banjat, stoan, portat e liqenit, portën e luanit, pagëzimoren, (monument paleokristian), kalanë Veneciane të Ali Pashës, etj.

Përveç vlerave historike, Butrinti shquhet për ekosistemin e mrekullueshëm. Rrënojat dhe ngrehinat e qytetit ndodhen në mes të një xhungle mahnitëse subtropikale, ku mbizotërojnë pemët e dafinës.

FINIQI

SARANDE - FINIQ 10 km

Teksa del nga Saranda, rruga nacionale të drejton në qytetin legjendar të Gjirokastrës, me një distancë prej 56 km. Vetëm 10 km nga Saranda, gjendet Finiqi, i emërtuar në antikitetet Foinike dhe njëkohësisht kryeqyteti i mbretërisë së Epirit. Foinike u themelua në shek. III-II para Krishtit, në territorin e Kaonisë. Polibi e quan: “Qyteti më i pasur dhe më i fortifikuar i Epirit”.

Më në Jugperëndim të Finiqit, në fshatin Mesopotam vendosur mbi një kodër, mund të vizitohet Kisha e Shën Kollit, ndërtim i periudhës bizantine. Një nga befasishtë më të këndshme të këtij udhëtimi është “Syri i Kaltër”, i cili është një burim i fuqishëm që ka krijuar një liqen të vogël, me ujë aq të kulluar sa të krijojë përshtypjen e një syri njerëzor të stërmadh. Në restorantin e “Syrit të Kaltër” specialitet kryesor është trofta e burimit.

ANTIGONEA

Antigonea është tashmë një Park Arkeologjik i cili gjendet në krahinën e Lunxhërisë në lindje të Gjirokastrës, pranë fshatit Saraqinisht. Ai është një qytet antik i shek. të II para Krishtit, viti 296. Mendohet se qyteti është themeluar nga mbreti Pirro i Epirit, i cili e quajti atë me këtë emër për nder të së shoqes, Antigonës. Rrënojat e qytetit antik ndodhen në një kodër, 600 metra mbi nivelin e detit. Ai zinte një sipërfaqe prej 35 hektarësh. Turistët mund të vizitojnë gjurmë dhe fragmente të murit rrethues, agoranë dhe stoan e qytetit, e cila është 59 metra e gjatë dhe 9 metra e gjërë. Për tu përmendur është gjetja e një statuje të vogël bronxi 17 cm të lartë, e cila i takon perëndisë së detit Poseidon, si edhe sfinksit i Antigonesë. Këto objekte gjenden të ekspozuara në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë.


GJIROKASTRA

Objekti kryesor është kalaja e qytetit e quajtur ndryshe edhe kalaja e Argjirosë. Historia e famshme e princeshës Argjiro i dha emrin ARGJIROKASTRO në vitin 1336. Në ambjentet e kalasë gjendet edhe Muzeu i Armëve, në të cilin janë të ekspozuara armë që prej periudhës së paleolitit e deri në Luftën e Dytë Botërore.

Gjatë qëndrimit në Gjirokastrë mund të vizitoni edhe Muzeun Etnografik. Qyteti i Gjirokastrës shquhet edhe për gatimet e tij të veçanta si “shapkati”, “laropit”, lloje të ndryshme byrekësh, si dhe prodhimet e bulmetit, të njohura në të gjithë Shqipërinë.

SARANDE - GJIROKASTRA 62 km

Për vlerat e saj arkitektonike Gjirokastra gjendet në listën e UNESCO-s. Gjithashtu dy objekte me interes për tu vizituar janë theatri i Sofratikës dhe Antigonea. Theatri, është një objekt i cili i përket një qyteti të periudhës romake i shek. II a.d. i quajtur Adrianopol, me kapacitet prej 4.000 shikuesish, e 27 shkallë. Mbasi kalohet Qafa e Muzinës, zbritet në rrugën nacionale Gjirokastrë-Kakavijë. Teksa lë, në të majtë fshatrat e Dropullit, shpaloset qyteti muze i Gjirokastrës, i ndërtuar në faqen lindore të Malit të Gjerë. Për shkak të artitekturës së saj, Gjirokastra quhet ndryshe; “qytet i gurtë” ose “qyteti i njëmijë shkallëve”. Është një qytet i lashtë, me vendbanime të hershme, mbi të cilat më vonë u ndërtua një fortifikim, që luajti rolin e bërthamës së qytetit. Ajo ç’ka tërheq më tepër vizitorin në Gjirokastrë janë shtëpitë e larta prej guri, të ngjajnë me kështjella të vogla dhe bien në sy si komplekse monumentale arkitektonike.



RRADHIMA

VLORE - NARTE 3 km

Në veri të qytetit të Vlorës ndodhet laguna e Nartës, e cila është laguna e dytë për nga madhësia në Shqipëri. Në të gjenden 195 lloje shpendësh, ndërsa kordoni që ndan lagunën nga deti është i mbuluar me pyje mesdhetare. Kjo është një pikë mjaft e mirë për vrojtimin e shpendëve ujorë si dhe për peshkimin.

Ujrat e lagunës janë të pasura me peshk, sidomos ngjala dhe levrek. Në Jug të lagunës ndodhet fshati i Nartës, i ngritur buzë ujrave të saj. I rrethuar nga kodra të buta të mbuluara me vreshta nga të cilat prodhohet një prej verërave artizanale më cilësore të Shqipërisë. Në lagunë ndodhet edhe fshati i Zvernecit, në ishullin pranë të cilit ndodhet Manastiri dhe Kisha e Shën Mërisë, e stilit bizantin.

Laguna mbyllet me kepin e Treportit, i cili së bashku me kodrën e pyllëzuar përbën një kompleks natyror mjaft të bukur turistik.



www.albaniantourism.com
info@albaniantourism.com

VLORE - RADHIME 22 km

Duke vazhduar turin, në drejtim të Jugut, do të keni mundësinë të njiheni dhe të shijoni këtë pjesë panoramike të ujrave të gjirit të Vlorës. Mbasi kaloni tunelin si pikë përcaktuese e Ujit të ftohtë, (ka marë këtë emër nga një burin malor që rrjedh në det), shfaqet zona turistike e Jonufrës, me plazhe të vegjël shkëmborë, të cilët shquhen për pastërtinë e ujrave.

Në vazhdim shtrihet zona e Radhimës, që zgjatet për kilometra deri në përroin e Dukatit, pranë qytetit të vogël të Orikumit. Plazhet e Radhimës ofrojnë një kolorit të bukur, në kontrast midis ujrave blu të detit dhe gjelbërimit të kodrave me bimësi mesdhetare, si plantacionet me ullinj dhe agrume. Gjiri i Vlorës paraqet interes të veçante për sportin e zhytjeve. Këtu gjenden anije të mbytura, siç është anija Italiane "PO", e fundosur në vitin 1941, gjatë Luftës italo-greke. Zonë me interes për zhytje është gjithashtu edhe plazhi i Zhironit, për vrojtimin e algave të gjelbërta e të zeza.



VLORA



Objekte me interes në qytetin e Vlorës janë muzeu i "Pavarësisë" (i ngritur në ish selinë e qeverisë së parë), ai i "Historisë" dhe "Etnografisë". Ndër objektet religjioze vlen të përmendet xhamia e Muradies e ndërtuar në vitin 1542 nga kryearkitekti i Perandorisë Otomane, Mimar Sinani, i cili ishte me origjinë nga kjo krahinë. Në një kodër dominante mbi qytet gjendet pika religjioze e "Kuzum Babait", objekt i sektit bektashi. Prej këtej ofrohet një pamje e bukur dhe madhështore drejt qytetit të Vlorës, gadishullit të Karaburunit, ishullit të Sazanit dhe lagunës së Nartës. Këtu ndodhen gjithashtu bare dhe restorante të këndshme.



Në qendër të qytetit, pranë Sheshit të Flamurit, janë zbuluar fragmente të mureve masive rrethuese të Aulonës. Në vitin 1081 ky qytet ra nën sundimin norman. Në shekullin XIV u përsifi në "Mbretërinë e Arbërisë" nën drejtimin e Balshajve (princa shqiptar). Në vitin 1417 u pushtua nga osmanët. Në 1812 qyteti ra në dorë të Ali Pashë Tepelenës dhe një shekull më vonë, më 28 Nëntor 1912, u bë kryeqyteti i parë i Shqipërisë së pavarur, me qeverinë e kryesuar nga Ismail Qemali.



Vlora është një prej qyteteve më të mëdhenj të Shqipërisë, si për hapsirë, popullsi, ashtu edhe për histori dhe lashtësi. Distanca nga kryeqyteti i vendit është rreth 130 km dhe nga aeroporti ndërkombëtar "Nënë Tereza" 120 km. Njëkohësisht ka portin e dytë më të madh të vendit. Ky qytet monumental daton në antikitetet që në shek. VI para Krishtit me emrin Aulona.



APOLLONIA

VLORE - APOLLONI 47 km

Apollonia ndodhet 12 kilometra larg qytetit të Fierit. Si qytet u themelua në fillim të shekullit të shtatë para Krishtit nga kolonizatorët grekë që vinin nga Korinti. Të dhënat e para të pranisë së tyre janë të dokumentuara rreth vitit 588 para Krishtit. Emrin qyteti e mori për nder të perëndisë Apollon. Ndër 24 qytete në të gjithë botën mesdhetare që mbanin këtë emër në antikitet, Apollonia e Ilirisë ishte më e rëndësishmja dhe luajti një rol të madh si ndërmjetëse tregtare mes helenëve dhe ilirëve. Apollonia ishte në atë kohë një qytet i madh e i rëndësishëm në afërsi të lumit Aaos (Vjosë). Llogaritet që qyteti të ketë patur rreth 60.000 banorë, një shifër rekord për Antikitetin. Ajo e ruajti madhësinë e saj edhe në periudhën romake. Oktavian Augusti studioi oratori në Apolloni.

Territori i madh i mbuluar me monumente, panoramat dhe peisazhet e mrekullueshme mbi fushën e Myzeqesë dhe Detin Adriatik nga njëra anë, si dhe rruga automobilistike, pozita e favorshme gjeografike pranë qyteteve të mëdha dhe plazheve të jugut nga ana tjetër, e bëjnë Parkun Arkeologjik, Apollonia lehtësisht të

arritshëm për vizitorin, dhe një destinacion të privilegjuar për turizmin kulturor në Shqipëri.



VLORE - ORIKUM 33 km

Në jug të gjirit të Vlorës ndodhet qyteti i vogël i Orikumit, pranë të cilit ndodhet një port jahtesh ku mund të parkohen deri në 650 të tillë. Orikumi ka qënë një prej qyteteve më të rëndësishme të botës antike. Ai është themeluar prej kolonëve nga ishulli i Eubeas gjatë kthimit të tyre nga Lufta e Trojës. Duke gëzuar një pozitë strategjike ai ka qënë porti kryesor i fisit ilir të Amantëve dhe ka luajtur rol në luftrat civile midis Cezarit dhe Pompeut. Objekti më i rëndësishëm për vizitorët është theatri antik i Orikumit, me kapacitet 400-500 spektatorë.




ORIKUMI

Një objekt tjetër interesant në këtë territor është Kisha e Marmirojt, e periudhës së hershme bizantine. Në periudhën bizantine porti i vogël i Orikumit është njohur me emrin "Jeriko". Në kohën e sundimit osman, Orikumi u quajt Pasha Liman.

Orikumi është një bazë e mirë për të eksploruar gadishullin e Karaburunit, i cili mbyll nga krahu perëndimor gjirin e Vlorës. Bregu perëndimor i Karaburunit është spektakolar me gjire dhe plazhe te vogla e të izoluara, me ujra të thellë e të pastërta.

Në veri të gadishullit gjendet shpella detare e Haxhi Alisë, (lundërtar ulqinak i shek XVII). Në shpatet rënësë, pranë plazhit të Gramës gjenden mbishkrime antike, nga ku rrjedh dhe emërtimi Gramata.



AMANTIA

VLORE - AMANTIA 20 km


Në krahun lindor të rrethit të Vlorës, pikërisht pranë fshatit Plloçë, ndodhen rrënojat e qytetit antik të Amantias, e cila që prej vitit 2005 është shpallur Park Arkeologjik. Amantia ishte kryeqyteti i fisit ilir të Amantëve.

Ajo u themelua në shekullin V -të para Krishtit dhe zinte një sipërfaqe prej 13 hektarësh.

Ndër objektet më interesante të zbuluara për vizitorin është stadiumi antik i Amantias, 60 metra i gjatë dhe 12,5 metra i gjerë si dhe fortifikimet.



Deti Adriatik



turri 2

DHERMIU

DHERMI - VUNO 8 km

8 km më në jug të Dhërmiut, gjendet fshati i Vunoit, i mirënjohur në zonë për traditat dhe patriotizmin shqiptar. Prej këtej merret drejtimi për në plazhin e bukur të Jalit, me gjire të mrekullueshme dhe shumë të veçanta nga pjesa tjetër e Rivierës.

Vunoi është një fshat karakteristik, ndërtuar në kodër përballë detit. Këtu gjenden kisha të vjetra si ato të Shën Spiridhonit e ndërtuar në 1778 dhe ajo e Mesodhisë me piktura të vitit 1783. Krahas tyre gjenden objekte të tilla arkitekturore, si rrënojat e banesës së Odise Kasnecit dhe banesa kullë e Shane Kotes.

VLORE - LLOGARA 40 km

Dhërmiu shquhet për plazhet me ujra të kthjellta, zallore, të vegjël e intime. Plazhet kryesore të Dhërmiut janë Jaliksari, Shkambo dhe Gjipea. Kjo e fundit shquhet për bukuri të rallë, pasi ndodhet rrëzë një kanioni rreth 70 metra të lartë. Pranë Dhërmiut ndodhet edhe shpella legjendare e "Piratëve".

Veprimtaritë kryesore që zhvillohen janë noti, sportet ujore si dhe zhytjet. Në Dhërmi gjenden një rrjet hotelesh, restorantesh, diskosh, e pub-esh, si dhe një kuzhinë tradicionale e ndërthurur me atë të huaj, ku mbizotërojnë specialitet e produkteve të detit.

Dhërmiu është një fshat piktoresk me atmosferë të veçantë. Ai dëshmohej si një vendbanim i vjetër që në vitet 49-48 (B.C.).

Në të gjenden manastiri i Shën Mërisë, kisha e Shën Todhrit, kisha e Ipapandisë dhe kisha e Shën Mitrit ku ruhen afrekse të shekujve XII dhe XIV.

PALASA

LLOGARA - PALASE 13 km

Pasi kalon qafën e Llogarasë, rruga e së cilës daton e hapur që në kohën e Pompeit, zbret në plazhet e Rivierës Shqiptare. Kjo zonë e ngrohtë mesdhetare ka 300 ditë me diell dhe temperatura mesatare e muajit Korrik, është 25 gradë C. Serinë e hap plazhi i Dhraleos, (Palasë), ishquarpër kthjelltësinë e ujit. Pikërisht në këtë plazh të emërtuar në atë kohë Palestra, ndaloi Pompei me ushtritë e tij. Në veri të plazhit, në drejtim të gadishullit të Karaburunit, ndodhet porti dhe gurorja e periudhës romake e quajtur Grama.

LLOGARA

VLORE - LLOGARA 40 km

Parku Kombëtar i Llogarasë, ndodhet në jug të qytetit të Vlorës, në një distancë prej afro 40 km. Territori i tij zë një hapësirë prej 810 ha. në malin e Llogarasë, në lartësitë 470 - 2.018 metra mbi nivelin e detit. Në pjesën ku kalon rruga nacionale Vlorë - Sarandë, të quajtur edhe qafa e Llogarasë, ky park shpalos tërë magjinë e tij në një lartësi 1.025 metra.

Përmbi të gjitha veçantinë e këtij parku natyror e shton edhe kombinimi i klimës malore me atë detare. Për afro 20 minuta, nëpërmjet rrugës automobilistike mund të shijosh plazhet e rivierës.

Bimët medicinale dhe dekorative ndërthuren me masivët e drurëve halorë.

Fauna e parkut përbëhet nga kafshë të shumëllojshme.

Parku i Llogarasë ofron akomodim e restorante, bare me shërbim bashkëkohor si dhe aktivitete të ndryshme.

Gjithashtu ushtrohen sportet ajrore, (të njohura edhe për takimet ndërkombëtare), si hedhje meparashutë dhe fluturime me deltaplan.



HIMARA

VUNO - HIMARE 4 km

Në vazhdim të turit tonë drejt jugut, shfaqet qyteti i vogël i Himarës, i cili përbëhet nga dy lagje; Himara e vjetër e ndërtuar lart në kodër dhe Himara e re në gjirin e Spilesë. Plazhet e Himarës janë Spilea, Llamani, Potami dhe Livadhet. Të gjithë janë plazhe zallore, me ujra të thellë dhe të kthjellët.

Një objekt mjaft interesant për tu vizituar është kalaja e Ali Pashait, e ndërtuar në një pozicion mjaft tërheqës mbi një gadishull të vogël në gjirin e vogël tektonik të Porto Palermos. Kalaja ka trajtë tre këndore dhe mure me lartësi 20 metra. Supozohet se kjo kala është ngritur mbi rrënojat e një kalaje të periudhës antike.

HIMARE - QEPARO 13 km

Himara gjallërohet shumë nga turistë të ardhur në stinën e verës ku krahas hoteleve, një vend të rëndësishëm zë turizmi familjar. Himara daton si një vendbanim i lashtë dhe qytet i fisit ilir të Kaonëve.

Ajo dëshmohet me këtë emër "Himera" që në shek. e V (B.C.). Emërtimi "Himera" është me origjinë pellazge. Në Himarë gjenden objekte kulti si Kisha e Shën Mërisë së Athalit, kisha e Kasiopisë, kisha e Gjithshënjtoreve dhe banesa monument kulture e Lilo Lllazarit.


QEPAROI & BORSHI

Pranë gjirit të Porto Palermos gjendet fshati i Qeparoit i cili ka plazhin e tij karakteristik. Me interes të veçantë, paraqitet Qeparoi i vjetër i ndërtuar në kodër. Në fshat gjenden objekte të tilla si kullat tre katëshe të Ali Pashës, Manastiri i Shën Dhimitrit, banesa e Minella Gjickës, etj. Fshati i Borshit ndodhet disa qindra metra larg nga bregu i detit dhe rreth 20 min largësi nga Himara. Plazhi i tij është më i madhi në tërë rivierën shqiptare me rreth 6 km gjatësi, ujë të kthjellët me zallishte. Në tërë gjatësinë e plazhit janë ndërtuar hotele që ofrojnë turizmin familjar, lokale, bare, disko, dhe restorante të shumëllojshme. Mikpritja e borshiotëve dhe tradita e tyre e gatimit të mishit të qingjit në hell është një karakteristikë e veçantë.

LUKOVA

BORSH - LUKOVE 16 km

Fshati i fundit në tërë gjatësinë bregdetare të Rivierës është Lukova, e shquar për brezaret me agrume dhe ullinj. Reth 2 km larg nga fshati, ndodhet plazhi i famshëm i Bunecit me përroin e mrekullueshëm, uji i kulluar i së cilit, derdhet në detin Jon. Në drejtimin jugor të plazheve të Lukovës, drejt gjirit të Kakomesë shtrihen për kilometra të tëra pllakat karakteristike prej stralli të bardhë verbues.



SHIROKA
& ZOGAJ

SHKODER - SHIROKE 4 km, - ZOGAJ 10 km

Farë pranë qytetit ndodhet liqeni i Shkodrës, më i madhi në gadishullin Ballkanik, me sipërfaqe 368 km², (Shqipërisë i përkasin 149 km²). E veçanta e tij është tipologjia e ndryshueshme e brigjeve. Bregu jugor është i ulët, i tipit të “marsheve”, ndërsa ai verior është breg i lartë dhe shkëmbor. Pikërisht këtu ndodhen edhe dy qendrat kryesore turistike, Shiroka dhe Zogaj, të njohura për restorantet e peshkut, ku specialiteti kryesor është gatimi karakteristik i “tavës së krapit”.

Klima e liqenit të Shkodrës është e ngrohtë me 250-260 ditë me diell në vit. Veprimtaritë kryesore janë noti, banjat e diellit dhe vozitja. Krahas këtyre potencialeve, liqeni i Shkodrës përbën edhe një ekosistem mjaft të rëndësishëm natyror. Këtu gjenden 281 specie shpendësh. Ujrat e liqenit janë të pasura me 45 lloje peshqish, ku më të rëndësishmit janë krapit, ngjala e shtojza .

SHKODRA

Atraksioni kryesor turistik i qytetit është kalaja e Rozafës, e cila ngrihet mbi një kodër shkëmbore në perëndim të qytetit, e rrethuar nga ujrat e tre lumenjve: Drinit, Bunës dhe Kirit. Kalaja ka origjinë Ilire. Sipas historianit Tit Liri, “ajo ishte vendi më i fortë i labeatëve”. Kalaja e Rozafës lidhet me fantazinë popullore. Rozafa, nusja më e re e tre vëllezërve që ngrinin muret e kalasë, u muros me qëllim që kalaja të arrinte të ndërtohej.

Uji gëlqeror që rrjedh në hyrje të kalasë, lidhet gjithashtu me legjendën popullore, sipas të cilës ai është qumështi i gjirit të Rozafës, i cili gjatë murimit u la jashtë për të ushqyer foshnjën e saj. Trajtën e sotme kalaja e ka marrë gjatë periudhës së sundimit të Balshajve. Ajo ka kaluar periudha të ndryshme nga të cilat ka gjurmët përkatëse, si ajo veneciane e osmane, (shek. XVI - XVII) dhe e Bushatllinjve (shek. XVIII - XIX). Objekte të tjera për tu vizituar në qytetin e Shkodrës janë, Muzeu Historik, Fototeka Marubi, etj.

Shkodra është një prej qyteteve më të vjetra të Shqipërisë, e themeluar në shek. IV (p.l.k.), si kryeqendër e fisit ilir të Labeatëve.

Gjatë historisë së saj, ka njohur pushtime të shumta, si ato romake, (168 p.l.k.), sërbe, (viti 1040), veneciane, (viti 1396), osmane, (viti 1479), kthimin në qendrën e principatës feudale shqiptare të Balshajve, (shek. XIV), si dhe në kryeqendrën e pashallëkut të madh të Bushatllinjve (1757-1831). Shkodra kondiserohet si një prej qyteteve me një trashëgimi të pasur kulturore, duke qënë vendlindja e një plejade të tërë artistësh, muzikantësh, piktorësh, fotografësh, poetësh dhe shkrimtarësh.

SHKODER - VELIPOJE 22 km

Plazhi i Velipojës ndodhet vetëm 22 km larg nga qyteti i Shkodrës. Ky është një plazh me gjatësi 4 km, i njohur për cilësinë e rërës me përmbajtje të lartë jodi. Krahas veprimtarive të ujit, (noti, peshkimi,) pranë plazhit të Velipojës gjenden objekte natyrore të vlefshme dhe interesante, siç është ishulli i vogël aluvional i “Franc Jozefit” i cili ndodhet në grykëderdhjen e lumit Buna në kufi me Malin e Zi.

LEZHA

SHKODER - LEZHE 41 km

Disa kilometra në jug të Shkodrës ndodhet qyteti i Lezhës, (gjithashtu një prej qyteteve më të vjetra të Shqipërisë), i përmendur për herë të parë me emrin Lissus. Në vitin 1398, (pas ndërtimit të kalasë në kodër), qyteti ishte në dorë të familjes feudale të Lekë Dukagjinit dhe më pas, ra nën sundimin e Venedikut.

Një ndër ngjarjet historike për Lezhën dhe për gjithë Shqipërinë është “Kuvendi i Lezhës” i mbajtur në 2 Mars 1444 nën udhëheqjen e Skënderbeut, i cili krijoi lidhjen e principatave shqiptare kundër rrezikut Otoman.

LEZHA

Objektet kryesore për tu vizituar në qytetin e Lezhës janë Memoriali i vendvarrimit të Skënderbeut, i cili u varros në katedralen e Shën Kollit në Lezhë në 1468, si dhe kalaja e Lezhës, e ngritur në një kodër, themelet e së cilës datojnë në periudhën Ilire.

Objekte interesante brenda kalasë janë rrenojat e periudhës osmane, xhamia, harku Romak dhe kulla Ilire.

SHENGJINI


LEZHE - SHENGJIN 7 km

Pranë qytetit ndodhet plazhi ranor i Shëngjinit rrëzë malit të Rencit, me 200-300 ditë diell në vit. Pranë Shëngjinit, në grykëderdhjen e Drinit, gjenden ekosisteme të shkëlqyera natyrore të vlefshme për ekoturizmin. Këtu gjendet parku kombëtar Kune-Vainit, me 70 lloje shpendësh, 22 lloje rreptilësh, 6 lloje amfibësh dhe 23 lloje gjitarësh.

KUNE

LEZHE - KUNE 5 km

Këtu gjendet parku kombëtar Kune - Vainit, me 70 lloje shpendësh, 22 lloje rreptilësh, 6 lloje amfibësh, 23 lloje gjitarësh. Një prej surprizave më të këndeshme është ishulli ranor i Kunes, i cili në varësi të prurjeve kthehet hera herës në gadishull. Kune është e mbuluar me një bimësi të dendur higrofile. Këtu rriten 227 lloje bimësh dhe është një vend i volitshëm për folëzimin e shpendëve dhe vrojtimin tyre.



Mbi vegjetacionin, deri në muajin maj, mund të ndeshësh borë të pastër dhe të pashkelur, që kontraston me ngjyrën e qiellit. Bimësia e këtij parku kombëtar përbëhet nga një varietet bimësh dhe drurësh ku një përhapje mjaft të madhe kanë në radhë të parë formacionet me drurin “Hormoq”. Lloji tjetër i bimësisë përbëhet nga ahishtet, rrobulli, arneni, gështenja, arra, molla e egër.

DRAGOBI - VALBONE 10 km

Valbona (ose Selimaj) gjendet 25 km larg nga qytetit i Bajram Currit dhe është qendra kryesore e banuar e luginës. Në këtë sektor lugina zgjerohet dhe ka mundësi për akomodim në shtëpitë e banorëve të zonës.

Gatimet karakteristike të kësaj zone janë specialitete të tilla si “mazja” “flija” “pitja” etj.

SHOSHAN - DRAGOBI 9 km

Mbas hyrjes në luginën e Valbonës do të kaloni me radhë disa fshatra. I pari është Dragobia, me shtëpitë e stilit alpin, ku lugina e lumit ngushtohet. Pas Dragobisë, në një shpat mali, aty ku derdhet përroi i Cerremit në Valbonë, ndodhet shpella e famshme e heroit kombëtar Bajram Curri.

BAJRAM CURRI - SHOSHAN 3 km

Para hyrjes në luginën e lumit të Valbonës, do të ndesheni me burimin (vrellën) e Shoshanit, i cili gjendet vetëm 3 km larg qytetit të Bajram Currit. Është një burim karstik dhe derdhet në lumin e Valbonës duke krijuar një kanion tërheqës me gjerësi 2-3 metra dhe me një thellësi prej 50 metrash.

Lugina e Valbonës shtrihet në pjesën lindore të Alpeve Shqiptare. Ajo është një prej zonave natyrore më të bukura të Shqipërisë, e shpallur Park kombëtar dhe zë një sipërfaqe prej 8.000 hektarësh. Largësia e këtij parku nga qyteti alpin i Bajram Currit është 20 -30 km.

VALBONA

Zona e luginës së Valbonës dhe e parkut në fjalë njihet për reshjet e dëborës, të cilat normalisht nisin nga fillimi i nëntorit dhe zgjasin deri në maj. Dëbora këtu krijon një shtresë mesatarisht të trashë prej 100 cm.

Në luginën e Valbonës janë të përhapura frutat e pyllit si, boronicat dhe luleshtrydhet. Fauna e kësaj zone përfaqësohet nga ariu i murmë, ujku, macja e egër, ndërsa mbi shkëmbinj mund të ndeshësh edhe tufat e dhive të egra. Në ujrat e lumit, gjendet e ashtuquajtura “trofta e mermertë”.

VALBONA


Në Parkun kombëtar të Valbonës mund të zhvillohen një sërë veprimtarish në natyrë, siç janë ekskursionet nëpër luginë dhe në përrenjtë e Cerremit dhe Kukajve, sporti i kanotazhit në zona të caktuara të lumit, skitë, ngjitjet alpinistike në shpatet e maleve, etj.

Valbona mund të shërbejë si bazë dhe për ngjitjet në malin e Jezercës, (maja e dytë më e lartë në Shqipëri), ecjet me kuaj përgjatë luginës së lumit si dhe peshkimi sportiv.

RRAGAMI

VALBONE - RRAGAM 10 km

Fshati i fundit përpara burimit të Valbonës është Rragami, i cili është një fshat i thellë i gjendur në mes të natyrës së virgjër. E gjithë lugina shquhet për një kolorit dhe bukuri të rrallë. Nga njëra anë janë ujërat e kristalta të Valbonës dhe nga ana tjetër shpatet e pjerrëta të maleve të veshura me bimësi të gjelbër.



BOGA

BOGE - THETH 17 km

Pas Bogës, vjen pika kryesore turistike e kësaj zone, Thethi, që gjendet rreth 70 km. larg Shkodrës. Për të mbërritur në Theth, duhet të kalohet Qafa e Terthorres, 2.000 metra mbi nivelin e detit. Prej këndej zbritet në gropën e Thethit, e përshkuar nga përroi me të njëjtin emër. Mbulesa e tij drunore përbëhet kryesisht nga masivet e ahut, të cilat zënë pothuaj 90 % të sipërfaqes së parkut.

Gjenden mjaft lule ku për t'u përmendur është "eulfenia e Baldachit", e zbuluar nga botanisti italian Baldachi. Kjo lule gjendet vetëm në Theth. E pasur dhe e larmishme paraqitet edhe fauna, ku spikatin Shqiponja dhe Rrëqebulli. Në ujrat e Përroit të Thethit gjendet trofta e mermertë.

Tepër e veçantë është shpella e Pucit, e cila gjendet në një lartësi 1.087 metra mbi nivelin e detit, me gjatësi prej 5 km dhe e pasur me stalaktite, stalagmite dhe vello muresh. Shpella ka disa kate dhe në pjesën qendrore ka pesë të tilla. Nëpërmjet galerive kjo shpellë lidhet me shpellën tjetër, e quajtur shpella e Husit.



RAZMA

RAZEM - BOGE 33 km

Nga Razma, rruga kthen në fshatin Dedaj e të drejton në pikën e Bogës, e cila gjendet mes Alpeve dhe është përshkruar nga udhëtarja e famshme angleze Edith Durham në librin e saj "Shqipëria, brenga e Ballkanit". Boga, ofron mundësi për veprimtarive të shumta, si ngjitje malore, ski dhe sidomos speleologji. Ndër këto të fundit rradhiten; shpella e Mullirit, shpella e Akullores, e Njerëzve të lagun etj.



SHKODER - RAZEM 41 km

Turi alpin shqiptar nuk mund të kuptohet pa vizitën në Alpet Perëndimore. Do të shijoni diçka që nuk e keni provuar kurrë: do të ecni, frymëmerrni, flini dhe hani midis legjendave të moçme që nga koha e Homerit dhe deri në modernitetin e sotëm. Ky tur, iu jep mundësinë të shijoni një pjesë të papërsëritshme të Alpeve Shqiptare, duke depërtuar deri në zemër të tyre, në Gropën e Thethit.

Fillesa e rrugës për në këtë rajon të lartë malor, është qyteti i Shkodrës, drejt pikës më të afërt (41 km larg) ndodhet Razma, e vendosur mbi një kodër "morenike", rrëzë malit të Veleçikut. Razma është një pikë klimaterike e mbuluar me pyjet e pishave dhe mështeknave. Njëkohësisht aty gjenden edhe lëndina e kullota alpine mahnitëse. E veçanta e Razmës është se pavarësisht rreshjeve të mëdha të dëborës, nuk bllokohet duke bërë të mundur të jetë e frekuentueshme gjatë gjithë dimrit. Këtu ofrohet akomodim, (janë duke u ndërtuar edhe hotele të rinj). Aktivitetet që zhvillohen në Razëm, janë ekskursionet, ngjitjet në mal, turizmi me çadra (gjatë verës) dhe skitë.



THETHI

Në zonën e Thethit gjenden objekte mjaft atraktive si “Ujëvara e Grunasit”, 25-30 metra e lartë. Mjaft interesante janë burimet e ujrave të ftohtë të Okolit si dhe shpellat e “Birreve me rathë” dhe “Arapit”. Në parkun e Thethit mund të zhvillohen një serë veprimtarishë të shumta si ngjitje alpinistike, ski, (sidomos në shpatin lindor), speleologji, peshkimi sportiv, biçikleta malore etj.

Akomodimi në Theth bëhet në shtëpitë e zonës të cilat janë me arkitekturë tipike alpine. Ushqimi karakteristik i kësaj zone është “fërliku”, (mish i pjekur), si dhe gatimi i troftës. Prej Thethit udhëtimi mund të vazhdojë nëpër luginën e lumit të Shalës duke u futur edhe më thellë në Alpe.

VERMOSHI

THETH - VERMOSH 82 km

Pikë tjetër që bën pjesë në rajonin e Alpeve Perëndimore është Vermoshi, i cili përbën edhe rajonin më verior të Shqipërisë.

Vermoshi gjendet 95 km larg nga qyteti i Shkodrës. E veçanta e parë gjatë këtij udhëtimi është Qafa e Rrapshit nga ku dallohet lumi i Cemit me ujrat e tij të kthjellëta, që kontrastojnë bukur me pejzazhin përreth.

Në pellgjet e vogla që krijon lumi gjatë stinës së verës, ai mund të shfrytëzohet edhe për banja dielli. Vermoshi bën pjesë në krahinën e Kelmendit, emërtim që vjen nga fjala latine “Climens” që do të thotë, i urtë, i thjeshtë, i mirë.

Vermoshi është i vendosur në një fushë malore në lartësinë 1.100 metra mbi nivelin e detit. Mbi të ngrihen shpate te larta. Në Vermosh mund të zhvillohen veprimtaritë tilla në natyrë si ngjitjet, skitë dhe gjuetia e troftës.

Përsa i përket ushqimeve të zonës së Kelmendit, mund të përmendim cilësinë e lartë të bulmetrave. Një tur në këtë zonë do t’iu bëjë të jetoni jo vetëm atmosferën e legjendave që nga koha e Homerit dhe modernitetit e sotëm, por mbi të gjitha, mikpritjen proverbiale shqiptare të njohur nga të gjithë të huajt që kanë pasur mundësi ta përjetojnë dhe shijojnë.

Mali
i
Zi

Vermoshi

turri 6

Kosova

Boga

Razma

Thethi

falas

DRILONI

POGRADEC - KORÇA 41 km

Pas Pogradecit unikal, ju pret surpriza e rradhës, Korça, një nga qendrat më të mëdha urbane të Shqipërisë. Në bulevardin kryesor po të jetë pranverë, do të kënaqeni me aromën e veçantë të blijve, ndërsa në dimër, është kënaqësi të ecësh nën kurorën e pemëve të mbuluara me dëborë.

Në vitin 1887 në Korçë u hap e para shkollë shqipe. Në periudhën e Luftës së Parë Botërore qyteti u pushtua nga francezët dhe në këtë kohë u shpall "Krahina Autonome e Korçës". Në vitin 1917 në këtë qytet u hap Liceu francez, një nga shkollat më të përmendura në Shqipëri.

Ajo që të bën përshtypje të veçantë është arkitektura, me shtëpitë tip vilash, rrethuar me kangjella dhe oborre të mbushura me lule të shumëllojshme. Veçanërisht mbreslnëse do të jetë për ju zona midis bulevardit "Republika" dhe "Shën Gjergji".

LINI

POGRADEC - LINI 25 km

Pak metra më poshtë, ndaloni në gadishullin e Linit dhe në fshatin me të njëjtin emër 25 km larg Pogradecit. Thuhet se në antikitet prindërit e perandorit Justinian e kishin Linit vendin më të pëlqyer për të pushuar. Veç pamjes magjike, këtu mund të vizitoni mozaikët në Bazilikën e Linit mbi kodër, të cilat datojnë në shek. VI-VII p.l.k. dhe shquhen për dekoracion të larmishëm zoomorf, bimor dhe gjeometrik dhe kanë ngjashmëri me mozaikët e Durrësit të lashtë.

POGRADEC - DRILONI 4 km

Buzë liqenit do të gjeni shumë restorante, bare dhe hotele komode. Shijoni peshkun dhe mënyrën e gatimit të tij tradicional dhe pikërisht tavën e famshme të Koranit. Gatimet e tjera tradicionale, si turshitë dhe "kollofacja", ju presin gati. Gjithashtu do të gjeni shumë lloje verërash, por shijoni verën tradicionale dhe unike të butit, ose rakinë e famshme "perla" dhe "moskat" të Pogradecit.

Mos u largoni nga Pogradeci pa vizituar Drilonin dhe Tushemishtin, 4-5 kilometra në jug të qytetit. Ujrat që dalin nga burimet e Drilonit formojnë një liqen tjetër të vogël. Përreth ka gjelbërim krejt të veçantë që e bën këtë vend bashkë me fshatin piktoresk të Tushemishtit, një oaz të papërsëritshëm qetësie dhe pushimi.

POGRADECI

Rrugës për në Pogradec, kalon pranë bregut të liqenit të Pogradecit, i cili me origjinën e tij tektonike dhe me thellësinë që arrin deri në 285 metra, është më i thelli në Ballkan. Liqeni me moshë 2-4 milion vjeçare, i cili për vlerat e tij unike është shpallur pasuri e UNESKOS-s, ruan në gjirin e tij 17 lloje peshqish nga të cilët 70 përqind janë endemikë dhe 30 përqind, lloje butakësh, ku veçohet sfungjeri i Ohrit, i cili, veç këtij liqeni, gjendet vetëm në Bajkal.

Në hapësirën e Pogradecit ju do të hyni nga rruga nacionale, e cila kryqëzohet në Majën e Qafëthanës me rrugën që vjen nga Maqedonia nga pika kufitare po me këtë emër.


Ju rekomandojmë që pikërisht ku kryqëzohen këto dy rrugë të mos harroni të keni me vete aparatet fotografike për të fiksuar një pamje të rrallë: Liqenin e Ohrit, një perlë e vërtetë në guaskën e Malit të Thatë në lindje dhe të Malësisë së Mokrës në perëndim. Në qytetin e Pogradecit, i banuar qysh në periudhën e neolitit dhe më pas nga fiset Ilire të Enkelejve dhe Dasaretëve, të cilëve u përket zanafilla e qytetit me kalanë e Pogradecit në një kodër 870 m. mbi nivelin e detit, mund të vini në çdo stinë të vitit, pasi ka një klimë të mrekullueshme.

KORÇA

Në këtë zonë ndodhet “Muzeu i Artit Mesjetar”. “Muzeu Prehistorik” i vendosur në dy banesa karakteristike korçare, do t’ju ofrojë 1200 objekte, të cilat përfaqësojnë gërmime arkeologjike nga zona prehistorike si dhe nga periodha helene, romake dhe paleobizantine.

Objekte të tjera me interes janë pazari i Korçës, (shek. XIX dhe fillimi i shek. XX), xhamia e Iliaz Bej Miharorit i vitit 1484 dhe Katedralja e Ngjalljes së Krishtit, ndër më të mëdhatë në Ballkan.

Në tavernat e qytetit do të gjeni një shije gatimi që nuk e keni provuar më parë. Mund të provoni shumë gjëra, por mos lini pa shijuar lakrorin me qepë e domate. Gjithashtu mos rrini pa provuar tavën e korminës. Natën nuk është çudi të dëgjoni grupet karakteristike korçare të këndojnë serenatat e ëmbla me kitarat poshtë ballkoneve me kangjella. Mos harroni dhe karnavalet, ceremonia e të cilave është më e bukura dhe më madhja se kudo në Shqipëri.



VOSKOPOJA

KORÇE - VOSKOPOJE 24 km

Voskopoja ka qenë ndër qendrat më të rëndësishme të Ballkanit, e njohur si vendbanim qysh në vitin 1330, ndërsa lulëzimin e madh e njohu në vitin 1794 kur numëronte 30.000 banorë. Voskopoja komunikonte me Laipcigun, Budapestin, Venedikun dhe Vienën. Qyteti nëmuronte 27 kisha, kishte një Akademi me bibliotekë si dhe shtypshkronjën e parë në Ballkan që në vitin 1720.

Mos lini pa vizituar Manastirin e Shën Prodhomit, kishën e Shën Kollit, (1721) ku gjenden pikturat e ikonografëve të shquar shqiptarë, David Selenicasi dhe vëllezërve Zografi nga Korça, të cilët kanë punuar edhe në malin e Athosit në Kalkidiki të Greqisë.

Në Voskopojë veç klimës së shëndetshme dhe ajrit të pishave, do të gjeni jo vetëm hotele të rehatshme, por edhe shtëpi ku zhvillohet turizmi familjar, ndërsa amatorët e skive një pistë natyrore skish.



DARDHA

KORÇE - DARDHE 20 km


Një pikë tjetër malore që s’duhet të harroni të vizitoni në Korçë, është Dardha, 20 km në juglindje të Korçës në një lartësi prej 1.350 m mbi nivelin e detit. Edhe këtu reshjet e borës vazhdojnë tre muaj, ajri është i kristaltë, uji nëpër çezmat e shumta prej guri është i ftohtë e i kulluar. Shijoni kostumet unikale popullore të grave ku mbizotëron e kuqja dhe e zeza (ngjyrat e flamurit tonë kombëtar). Provoni nëpër shtëpitë karakteristike prej guri që të ofrojnë mikpritjen e tyre të turizmit shtëpiak, rakinë e kumbullës dhe lakrorin me dy petë.



VITHKUQI

KORÇE - VITHKUQ 27 km

Fshati malor i Vithkuqit, vendlindja e pionierit të Rilindjes Kombëtare, Naum Veqilharxhi, ndodhet 25 km në jug-perëndim të qytetit të Korçës dhe ka qenë një vendbanim mesjetar në shek. XVII-XVII, gjithashtu dhe një qendër e përmendur ekonomike-kulturore. Në Vithkuq duhet patjetër të pini njëherë ujë tek burimi i Bellovodës dhe të planifikoni patjetër një vizitë në kishat e Shën Pjetrit dhe të Shën Pavlit. Ata që kanë më shumë kohë duhet të bëjnë një ngjitje me këmbë ose me kalë në majën e Rungajës, 1.750 m mbi nivelin e detit. Për strehim mos u shqetësoni, sepse shtëpitë karakteristike do t’ju ofrojnë një qëndrim të këndshëm dhe do t’u plotësojnë të gjitha kushtet.



turizmi

Greqia

falas

PËRMETI

KELCYRE - PERMET 20 km

Në restorantet e Përmetit, brenda dhe jashtë qytetit, do të gjeni një kuzhinë tepër të veçantë dhe një pastërti e shërbim mbresëlënës.

Veç gatimeve karakteristike të zarzavateve, për të cilat Përmeti është aq i përmendur, do të provoni ingjinarin e gatuar me vaj ulliri, mishin e gjahut; thëllëzën e malit e mbushur me përsesh, derrin dhe lepurin e egër, peshkun e shijshëm të Vjosës, etj. Gjithashtu do të shijoni verën Kabërnë, Merlot, etj, dhe rakinë e famshme tradicionale përmetare. Pa harruar sigurisht, glikotë e mrekullueshme me të gjitha llojet e frutave dhe veçanërisht glikoja e arrës.



Në Përmet do të shijoni qetësinë relaksuese, lulet dhe gjelbërimin e pafund. Do të gjeni një mikpritje dhe dashamirësi prekëse, në rrugë, shtëpi, apo në restorante dhe hotele. Një natë në hotelet buzë Vjosës, të cilët janë aq të këndshëm dhe komodë, do t'iu japë ndjesinë sikur flini mbi valët e Vjosës. Në qoftë verë, në Përmet do të gjeni plazhe të shumtë, në pellgje të formuara si xhepa në brigjet e Vjosës.

KËLCYRA


Një lumë i vrullshëm dhe i kaltër, me peshk të shijshëm dhe të bollshëm, dhe katarakte mahnitëse. Ju nuk mund të vazhdoni rrugën drejt Përmetit pa shijuar një drekë në restorantet e Grykës së Këlcyrës, me mish qingji dhe produkte blegtorale nga kullotat e pastra dhe të pasura të zonës. Të kaloni qoftë edhe një natë në hotelet e Grykës së Këlcyrës do të përjetoni diçka që nuk e gjen në asnjë vend tjetër, në mes të këtyre pamjeve mahnitëse natyrore.



Pasi të kaloni qytetin e vogël të Këlcyrës, i njohur në antikitet me emrin "Klistyra", nëpërmjet luginës së lumit Vjosa, (Aos, në antikitet), do të shijoni malet hijerëndë të Dhëmbelit, Trebeshinës, Kokojkës dhe në horizont, Nemërçka, si "një zonjë e rëndë dhe e madhe", që përkundin në gjirin e tyre një luginë të qëndisur nga dora punëtore dhe e mençur e njerëzve të kësaj treve të veçantë.



Teksa vjen nga Gjirokastra, ose Tepelena, shfaqet gryka e Këlcyrës. Kjo portë natyrore e luginës së Vjosës, do t'ju thotë e para "mirësevini", duke ju shpalosur bukuritë natyrore, me malet e lartë shumëngjyrësh dhe lumin madhështor të Vjosës.



PËRMETI


Përmeti, qyteti i luleve, trëndafilave, këngëve të pashoqe, pastërtisë dhe qetësisë, (i njohur në antikitet me emrin “Tryfilia”, i banuar nga fise Ilire), njihet si qendër administrative që në shek. XV. Janë të përmendura pazaret e tij të shumta dhe të pasura që vizitoheshin nga shumë vende të tjera ballkanike. Sot, ju ftojmë të vizitoni “Gurin e Qytetit”, një masiv shkëmbor monumental befasues, që natyra ia ka dhuruar bujarisht qytetit për ta bërë atë krejt të veçantë. Vizitoni kishat, e sidomos kisha e Leusës, (shek.XVIII), e cila shquhet për ikonostasin dhe gdhëndiet në dru, si dhe kishën e Shën Mërisë në Kosinë, (shek.XII). Megjithëse një qytet i vogël, Përmeti është vendlindja e shumë artistëve të mëdhenj të panteonit shqiptar, të politikës, shkencës, të letrave, muzikës dhe arteve figurative.



FRASHËRI

PERMET - FRASHER 30 km

Me që jemi në panteonin shqiptar, mos humbni rastin pa u ngjitur në Frashërin malor, rreth 30 km larg qytetit. Është vendlindja e vëllezërve Frashëri dhe e shumë personaliteteve të tjera të shquara, që kanë venë themelet e kombit shqiptar dhe që kanë përcaktuar atë që sot e quajmë genin shqiptar. Në muajin qershor, organizohet një takim kombëtar kushtuar figurave të shquara që kanë lindur në Frashër. Por nuk është vetëm kjo arsyeja që iu grishim për në Frashër. Rrugës për në këtë fshat malor ju do të kaloni, mes përmes Parkut Kombëtar të Bredhit të Hotovës. Një panoramë e papërsëritshme, midis bredhave dhe pishave të panumërta, midis burimeve me ujë e ftohtë qelibar.




BËNJA

PERMET - BENJE 3 km

Nuk mund t'i themi “mirëupafshim” Përmetit pa u kthyer në ujërat termale të Bënjës dhe luginës së Lengaricës vetëm rreth 3 km larg qytetit. Janë 6 burime natyrore të hapura, me ujë të ngrohtë edhe në dimër, shumë kuruese për sëmundje të ndryshme. Këto ujëra burojnë nga kanionet e bukura të dy urave të kohës së Ali Pashë Tepelenës; Ura e Kaikut dhe ajo e Dashit. Teksa largohemi nga Përmeti, rruga na çon drejt kufirit grek, (i cili ndodhet vetëm 30 km larg), dhe drejt Leskovikut të famshëm për ujrat termale të Vronomeros dhe banjat e avullit të Postenanit.



Gjithmonë në shoqërinë e Vjosës, buzë së cilës do të shikoni gjithmonë amatorë peshku, ndërsa në kohën e verës edhe një garë të përvitshme kanotazhi ku lundëtarët nisen që nga Greqia fqinje, buzë maleve të Pindit nga nis rrjedhën Vjosa dhe priten me ceremoni në Përmet. Ky ritual i përvitshëm, përsëritet edhe për dy veprimtari të tjera, Festivali Ndërkombëtar Multikulturor, i cili organizohet në qershor dhe “Dita e verërave”, që zhvillohet në muajin maj.



Berati, krenaria e lashtësisë dhe arkitekturës shqiptare, i shpallur në mbrojtje nga UNESCO, ndodhet rreth 120 km nga Tirana. Me një moshë 2.407 vjeçare, ai është një ndërthurje e mahnitëshme e kulturave, zakoneve dhe mentaliteteve lindore dhe perëndimore. Ai është gjithashtu një teatër i pashtershëm i historisë shqiptare, zhvillimeve të saj dhe një dëshmi e genit shqiptar dhe prirjes së tij për të bashkëjetuar, e bashkëpunuar me kulturën botërore.

Jeta e këtij qyteti lindi si qendër banimi ilir në shek VI -V (p.l.k).

Më vonë, në shekullin e III (p.l.k), u kthye në qytet kështjellë, i njohur me emrin “Antipatrea”. Zgjerimi më i madh i kështjellës u bë gjatë sundimit të familjes feudale shqiptare të Muzakajve.

Brenda kalasë u ndërtuan kisha me afreske e ikona të çmuara, si dhe një shkollë kaligrafie. E veçanta është se kalaja e Beratit vazhdon të banohet edhe në ditët e sotme. Ajo çka e tërheq vizitorin në këtë qytet janë lagjet muzeale të Mangalemit, Goricës dhe Kalasë, ku bien në sy fasadat e shtëpive me shumë dritare të vendosura njëra mbi tjetrën. Kjo e bën qytetin të quhet ndryshe “qyteti i një mbi një dritareve”. Banesa tipike është me dy kate, ku kati i sipërm është i dalë me shumë dritare me harqe e gdhendie druri.

Është i rallë dhe i jashtëzakonshëm në Berat kompleksi i kishave bizantine, ndër të cilat mund të përmendim kishën e Shën Mërisë së Vllahernës (shek i XIII), Shën Triadhës, të cilat ndodhen në kala. Në rrëzë të kalasë gjendet kisha bizantine e Shën Mëhillit.

Një monument postbizantin, i cili ndodhet në kala, është katedralja e Shën Mërisë, e ndërtuar në vitin 1797. Në të ndodhet muzeu i ikonave të ikonografëve të shquar të shek. XVI, Onufri dhe të birit të tij Nikollës. Këtu janë të ekspozuara mbi 100 ikona, të cilat i përkasin edhe autorëve të tjerë si Johan Cetirit, Onufër Qipriotit dhe autorëve anonimë. Në hyrje të muzeut gjendet një ikonostas i vitit 1806 me gdhendie të thellë. Ndërsa në lagjen Goricë ndodhet manastiri i Shën Spiridhonit.

Në vitin 1417 Berati u pushtua nga osmanët. Ky pushtim la gjurmë në ndërtimin e monumenteve religjioze të fesë islame, siç janë Xhamia e Kuqe, (brënda kalasë), Xhamia e Beqarëve (1827), Xhamia e Plumbit (1555) dhe Xhamia Mbret në shek XVI.

Një monument mjaft i bukur arkitekturor i qytetit është ura Goricës, e cila lidh lagjen e Mangalemit me Goricën. Kjo urë (ndërtuar në vitin 1780) është me harqe. Objekte të tjera për t’u vizituar janë Muzeu Etnografik, i cili ndodhet në një ndërtesë të shekullit të XVIII me çardak, si dhe galeria e artit “Eduard Lir”, piktor i njohur anglez që e ka piktuar aq shumë Beratin dhe Shqipërinë.

Berati është i njohur edhe për gatimet e tij karakteristike. Specialitete kryesore janë “Pula me përsesh”, “Çorba e Tomorrit”, etj.



TOMORRI

BERAT - MALI I TOMORRIT 30 km

Qyteti i Beratit është një pikënisje e mirë për të eksploruar malin e Tomorrit, i quajtur ndryshe “Olimpi Shqiptar”, ose fronti i perëndive, i cili gjendet në një distancë prej 30-40 km larg nga qyteti. Mali i Tomorrit shquhet për madhësinë mahnitëse e cila të kujton një luan gjigand të ulur. Ky mal është ndër më të lartët e Shqipërisë, me lartësi 2.416 metra mbi nivelin e detit. Mjaft i bukur është veçanërisht shpati perëndimor i malit, mbuluar me bimësi të shumëllojshme. Bimësia e parkut të Tomorrit përbëhet nga drurë si, ah, rrobulli, panja, frashëri, pisha e bredhi. Ndërsa fauna përfaqësohet nga ariu i murmë, ujku, dhelpra, nusja e lalës, lepuri i egër, etj.


Mali i Tomorrit është një pikë e favorshme për ngjitjet alpinistike, trekking-un, etj. Zona rrëzë Tomorrit është ideale për ngritjen e kampingjeve. Gjithashtu në këtë mal në lartësinë 1.200 mbi nivelin e detit gjendet “Tyrbja e Kulmakut” me varrin e Abaz Aliut, shenjtit të besimtarëve të fesë bektashiane. Gjatë çdo muaji gusht këtu zhvillohet pelegrinazhi për në varrin e tij dhe shoqërohet me kurbanë të shumta. Ky është pelegrinazhi më i madh në Shqipëri i Sektit bektashi, e më gjërë.

OSUMI

BERAT - KANIONET E OSUMIT 30 km

Duke vazhduar drejt luginës së lumit Osum, pikërisht në fshatin Radësh në rrjedhën e përroit të Çorovodës, gjendet shpella e Pirrogoshit. Ajo përfaqëson shpellën më të madhe dhe më të gjatë të Shqipërisë prej rreth 1.500 metrash. Hyrja ka një gjerësi prej 5 m. Pjesa më interesante është korridori i madh, ku gjenden forma të shumta karstike. Ajo përfundon me një pus të thellë, ku gjenden kolonitë e lakuriqëve të natës. Pranë shpellës ndodhet kanioni i Gradecit, që padyshim është kanioni më i bukur dhe më spektakolar i luginës së Osumit.

Ai ka një gjatësi prej 4 km dhe është mjaft i ngushtë, me gjërësi vetëm 1,5 metra. Lartësia e tij është 40 metra dhe shpatet bien thikë mbi lumë. Për të arritur në kanionet e tjera të Osumit, udhëtimi vazhdon drejt jugut të luginës. Kanionet gjenden 3 km në jug të qytetit të Çorovodës. Janë objekte natyrore madhështore me gjatësi 15 km. Në këtë rajon zhvillohet sporti ujor i kanotazhit. Krahas tyre, pellgje të vaçanta janë të përshtatshme për plazh, siç është ai i Varishtës.



turi 9

Radeshi
Çorovoda

falas

TIRANA

TIRANE - KRUJE 45 km

Qyteti Historik i Krujës ndodhet 32 km larg Tiranës, i ndërtuar në një shpat mali panoramik me lartësi afro 600 metra mbi nivelin e detit. Ky qytet, është një prej pikave më tërheqëse turistike të vendit, si nga bukuria dhe nga historia e tij. Prej këtej Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, mbrojti Shqipërinë dhe qytetërimin evropian nga otomanët.

Objekti kryesor i qytetit, është Muzeu i Heroit Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, i ndodhur në kala, e cila ka origjinë ilire, por që formën e sotme e ka marrë gjatë shekujve V -VI (m.k). Kalaja ka 9 kulla dhe brenda saj ndodhen edhe disa shtëpi të banuara si dhe Teqja e Dollmasë. Në perëndim të kalasë gjenden edhe hamami i shek. VI (m.k). Gjithashtu në kala ndodhet Muzeu Etnografik, në një shtëpi tipike me çardak që i përkiste familjes së shquar të Toptanëve. Pranë kalasë gjendet pazari karakteristik i Krujës, njërit prej tregjeve më të pasur të prodhimeve të artizanatit. Ky Pazar ka funksionuar që prej shekullit të XV (m.k.).

Kulinaria është një aspekt tjetër kënaqësie që ju ofron Tirana, me guzhinën e pasur tradicionale, si dhe guzhinat e shumëllojshme të huaja, nga kineze dhe deri tek ajo italiane. Përveç qëndrës, edhe lokalet e ndryshme në malin e Dajtit janë vërtet një kënaqësi e rrallë dhe një surprizë që ja vlen ta zbuloni.

Si kryeqytet, Tirana ofron muzetë, teatrot dhe galeritë më të shquara të vendit. Mjaft interesante për ju do të jetë vizita në Muzeun Historik Kombëtar, Muzeun Arkeologjik, Muzeun e Shkencave të Natyrës, muzeun privat “Mezuraj” si dhe në Galerinë Kombëtare të Arteve. Mbrëmja juaj zbkurohet akoma më shumë, teksa mund të kaloni pak orë të këndshme në Teatrin Kombëtar, apo në Teatrin e Operas dhe Baletit.

Për origjinën e emrit të qytetit ka mendime të ndryshme, njëri prej të cilëve supozon se vjen nga TYRRENIA, (emërtim me origjinë etruske). Ka dhe mendime të tjera si emërtimet “theranda” (të korra), “Tirkan” (kështjellë në shpatin e malit të Dajtit), etj.

TIRANA

Turi i juaj mund të kombinohet midis vizitës së muzeumeve dhe pikave kryesore atraktive të qytetit, ndër të cilat do të përmendim Sheshin Skënderbej, ku ndodhen Xhamia e Et’hem Beut, (ndërtuar midis viteve 1798-1812) dhe kulla e Sahatit, e ndërtuar në vitin 1822, (35 metra e lartë), me kupolë të stilit “San Marko”. Objekte të tjera me interes për tu vizituar janë “Mozaiku” i zbuluar në dyshe-menë e një vile të vjetër romake.

Në qendër, janë muret e kalasë së perandorit Justinian, (datojnë në vitin 520 p.k),varri monumental i Kapllan Pashës, si dhe ura e Tabakëve, (fillim shek. XIX).

Zemra e Shqipërisë, kryeqyteti Tiranë, si gjithë metropolet e tjera evropiane, ka energji dhe lëvizje të pashtershme. Me baret, pubet, restorantet dhe tavernat, Tirana është e bukur për t’u zbuluar dhe shijuar, si ditën ashtu edhe natën.

Mikpritja dhe ngrohtësia për turistët është një veçanti karakteristike që të shoqëron në rrugë dhe kudo.



DURRËSI

TIRANE - DURRES 34 km

Porti më i madh i vendit ndodhet 34 km larg Tiranës. Është qyteti më i vjetër i Shqipërisë, me histori 3.000 vjeçare. Është themeluar në vitin 627 (p.l.k.) nga kolonë korinthus dhe koryras në trojet e fisit ilir të Taulantëve. Objekti kryesor është amfiteatri i periudhës së perandorit romak Adrian, me një kapacitet prej 15.000 shikuesish dhe radhitet i dyti në Ballkan për nga madhësia. Në shekullin e IX, në muret e tij u ndërtua një kapele e vogël me mure të veshura me mozaikë. Objekt tjetër arkeologjik janë termat e shek. të II. Gjithashtu mjaft interesant është forumi bizantin, i shek. V-VI me kolona mermeri. Në qytetin e Durrësit, gjenden 1/3 e gjatësisë së mureve të kalasë së qytetit. Objekti më i famshëm arkeologjik i zbuluar këtu është mozaiku “Bukuroshja e Durrësit”, që i përket shekullit të IV (p.l.k.).



Muzeu Arkeologjik që ndodhet në Durrës në një godinë të re në shëtitoren “Taulantia”, është ndër më të rëndësishmit e këtij lloji në Shqipëri dhe me interes të veçantë për tu vizituar. Gjithashtu Durrësi është edhe një qytet i këndshëm për pushime, sepse ka një plazh ranor me të gjitha ambientet bashkohore të akomodimit. Nga jeta e ditës dhe e natës ai ka marë tashmë pamjen e një metropoli të vërtetë.



ELBASANI

TIRANE - ELBASAN 50 km

Në krahun e djathtë të derdhjes së Shkumbinit atje ku ai kryqëzohet me rrugën e famshme Egnatia, shtrihet qyteti i Elbasanit me emrin e lashtë Skampini, rreth 50 km larg nga kryeqyteti. Skampini ishte fortifikatë tipike romake, por në shekullin e IV-të, kishte arritur një status të ri administrativ dhe me emrin “Hiskampis”. Ai përcaktohej si një nga qytetet me rëndësi të Epirit të Ri ku ishte stacionuar i vetmi legjion ushtarak. Sipas Tit Livit, Pirroja i Epirit ishte i pari që mësoi të tjerët si vendosej kampi i fushimit, prandaj fortifikimi i Elbasanit ka formën kuadratike. Në shek. VI qyteti zhvillohet jashtë kështjellës duke qenë qendër peshkopate me një numër katedralesh dhe një bazilikë të madhe në kodrën e Tepes, pranë Kalasë.



Në vitin 1466 Kalaja e Elbasanit bie në duart e osmanëve të cilët e rindërtuan thujse tërësisht dhe prej tyre ai mori emrin Elbasan. Me këtë emër u bë qendër sanxhaku në shek. XVII-XVIII duke patur një zejтари tejet të zhvilluar dhe një tregti brenda dhe jashtë vendit. Sot vizitori mund t’i prekë të gjitha këto dëshmi të cilat ruhen me kujdes, por mund të gjejë edhe një qytet komod me hotelet, restorantet dhe baret e nevojshme si brenda ashtu edhe në periferi të tij.

